



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT**

Ballsh, më _____.____.2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Blerje automjete (nje kamion per transportin e mbetjeve urbane dhe nje mjet per hapje rruges)”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 34114000-9 - Automjete të specializuara, 34134200-7 - Kamionë vetëshkarkues

Vlera e fondit limit:

15.933.333 (pesëmbëdhjetëmilion e nëntëqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Bazuar në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër, për nevoja të NSHP-se.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhërin përkatës të prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesës (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26, 29 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në pikën 1, 2/b dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”. .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën

vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2025 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohesh pranë Qendrës Kombëtare të

Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetëdeklarim nëpërmjet të cilës marrin përsipër që ”Garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve në motorr, kambio dhe sistemin elektrik do të jetë 2 (dy) vite nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)”.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vërtetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë se nëse shpallen fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Mallkastër.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik” i ndryshuar, për të garanuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe kalimin e pronësisë pa patur kosto shtesë për AK-në pasi ky i fundit nuk ka parashikuar kosto të tjera.

2.3.4. Për mjetin duhet të paraqiten fotografi të qarta nga të gjitha anët dhe origjinale.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 6/b të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garanuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë vendndodhjen e mjetit (adresën e saktë) si dhe të dhënat përkatëse të mjetit me qëllim që Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër të bëjë verifikimin fizik të gjendjes teknike dhe vizuale të mjetit përpara shpalljes së ofertës fituese për operatorët ekonomik të kualifikuar sipas renditjes. Përben kusht për skualifikim nëse nga verifikimi vërehet se kemi mospërputhje të mjeteve me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garanuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkt (mjet) funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6. Njëkohësisht operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi për mjetin që do të ofertojnë duhet të paraqesin dhe të ngarkojnë në sistemin e prokurimit skeden teknike me të dhënat përkatëse të mjetit shoqëruar me dokumentacionin përkatës të mjetit si më poshtë:

- Lejë qarkullimi shqipëtare
- Targa Shqiptare
- Siguracion
- Të ketë kryer kontrollin teknik me cilësinë “kalon”.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 6/c dhe pika 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garanuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale (mjetin) dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përgatitur nga strukturat përkatëse të NSHP-së. Specifikimet teknike për mallrat e kërkuara, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

Afati i Ekzekutimit: 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT